

Iniciativa Ndërinstitucionale për Zgjidhje të Qëndrueshme për Personat e Zhvendosur nga Kosova

Përmbledhje

Grupi i Punues për Zbatimin (GPZ) e Iniciativës Ndër-Institucionale për Personat e Zhvendosur (i njohur si 'Procesi i Shkupit') i lehtësuar nga OSBE dhe UNHCR u zhvillua në Durrës, Shqipëri më datë 29 gusht - 1 shtator 2018. Institucioni kryesor përgjegjës për këtë proces në Kosovë është Ministria për Komunitete dhe Kthim.



Qëllimi i GPZ ishte matja e progresit dhe lehtësimi i mëtejshëm i zbatimit të masave dhe pikave të veprimit në Kosovë që do të mbështesin zgjidhjet e qëndrueshme për personat e zhvendosur duke bërë së bashku më shumë se 40 pika fokale relevante institucionale (Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Financave, Zyra e Kryeministrit, Policia e Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Zyra e Prokurorit të Shtetit, Agjencia e Regjistrimit Civil, Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikimit të Pronave - AKKVP).

Të drejtat pronësore

- Është shënuar progres në fushën e lirit të personave të zhvendosur nga pagesa e borxhit tatimor të akumuluar për periudhën kur prona e tyre ishte e uzurpuar në mënyrë të paligjshme. Nga data 1 tetor e vitit 2018, komunat do të duhet të shlyejnë borxhet e tilla bazuar në vendimet e autoriteteve që merren me uzurpim të paligjshëm.
- MKK-ja dhe Zyra e Kryeministrit do të publikojnë një qarkore (letër informimi) për të informuar kompanitë e shërbimeve publike lidhur me detyrimet e tyre ligjore për të shlyer borxhet e

akumuluar të shërbimeve publike për personat e zhvendosur sa i përket periudhave gjatë të cilave ata nuk kanë qenë në posedim të pronës së tyre.

- Ligji për AKKVP-në është në procedurën e ndryshimit për të lejuar vazhdimin e administrimit të pronës dhe dëbimeve të shumta në rastet e ri-uzurpimit të paligjshëm të pronave.
- Është miratuar një Udhëzim Administrativ i AKKVP-së, si dhe i janë ndarë 600,000 euro AKKVP-së për të zgjidhur kërkesat e kompensimit që nga koha e Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore.

Siguria, Dialogu dhe Riintegrimi

- Pas hartimit të udhëzimeve për reagimet nga mekanizmat e nivelit lokal në incidentet që prekin komunitetet dhe zhvillimit të një numri të trajnimeve përkatëse për zyrtarët komunal, janë vërejtur dënimet e incidenteve të sigurisë në Novobërdë, Mitrovicë të Jugut, Kamenicë, Ferizaj, Istog dhe Vushtrri.
- Pas miratimit të Memorandumit për Krimet e Urrejtjes, si dokumente udhëzuese, do të përgatiten udhëzimet për adresimin e krimeve të urrejtjes në Kosovë për Zyrën e Kryeprokurorit dhe Policinë e Kosovës dhe të njëjtat do të kenë në fokus të kthyerit.
- Qarkorja do të hartohet dhe do t'i shpërndahet të gjithë Këshillave Komunal për Siguri në Bashkësi që t'u bëhet thirrje për përfshirjen e komuniteteve në planet e tyre vjetore të punës. Komunitat pritet të alokojnë buxhet për aktivitetet e bazuara në komunitete dhe veçanërisht në dialogun ndërmjet komuniteteve gjë e cila kërkon përpjekje më të koordinuara nga autoritetet lokale.

Dokumentet personale

- Vendimi i ri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, i zbatueshëm që prej datës 27 gusht të vitit 2018, trajton çështjet me të cilat përballen personat e zhvendosur sa i përket njohjes së dokumenteve të lëshuara nga zyrat e zhvendosura të regjistrimit. Ky zhvillim i ri do të përkrahët me një fushatë informimi të bërë për të informuar personat e zhvendosur lidhur me mundësitë e qasjes në dokumentacionin personal.
- Për t'iu mundësuar personave të kthyer që ta dëshmojnë vendbanimin e tyre, që është parakusht për inicimin e regjistrimit të gjendjes civile, ZKKK pritet të lëshojë certifikata që konfirmojnë vendbanimin të cilat do t'iu mundësojë personave të zhvendosur të gëzojnë të drejtat e tyre. Modeli i certifikatës do të jetë i bashkangjitur në Udhëzimet për zbatimin e Rregullores për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme të miratuar më herët këtë vit.

Menaxhimi i të dhënave

- Procesi i prokurimit për zhvillimin e bazës së të dhënave që do të mbështesë procesin e kthimit është në vazhdim e sipër. Ndërkohë, sipas kërkesës së delegacioneve, UNHCR do të vazhdojë të veprojë si përfaqësues për shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve të ndryshme të përfshira në procesin e kthimit.

Planifikimi i Zgjidhjeve

- Rregullorja për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme e sponsorizuar nga MKK është miratuar nga Qeveria më 4 janar të vitit 2018. Ky akt normativ parasheh një përshkrim gjithëpërfshirës të procesit të kthimit vullnetar dhe zgjidhjeve të tjera të qëndrueshme, të autoriteteve kompetente dhe përgjegjësive të tyre, të procedurave të aplikimit dhe përzgjedhjes për kthimin e asistuar, kriterëve, pakove të asistencës, qasjes së përgjithshme në të drejtat dhe shërbimet për personat e zhvendosur/të kthyerit. Udhëzimet përkatëse për zbatimin e Rregullores pritet të finalizohen së shpejti.
- Hapi tjetër që duhet ndërmarrë është zhvillimi i Strategjisë gjithëpërfshirëse të mobilizimit të donatorëve. Vlerësimi i nevojave i kryer në rajon me 4000 PZh që shprehin interes për t'u kthyer tani siguron kontribut të mjaftueshëm për të planifikuar zgjidhje të përbashkëta duke përfshirë këtu edhe mbledhjen e fondeve nga donatorët.



Që nga muaji dhjetor i vitit 2014, UNHCR dhe OSBE kanë përkrahur MKK-në në lansimin e një procesi rajonal të përkushtuar për gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova. Institucionet përkatëse të Prishtinës, Beogradit, Shkupit dhe Podgoricës, me qëllim të mbështetjes së zgjidhjeve afatgjata për personat e zhvendosur nga Kosova, takohen rregullisht përmes këtij procesi rajonal.

Shtator 2018